ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Për: Aktivitetin e Prokurimit: " Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit – ritender"

Nr1 i prokurimit	**214-24-3710-2-1-1**
Nr i brendshëm	**214-24-14-211**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Aroma Plus SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. Ndue Perlleshi, LLA/3

(Adresa)

Prishtinë **10 000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

045 645 088

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Mirvete Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpk.aroma@gmail.com

(Adresa elektronike)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

05.07.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ARGMA PLUS Prishtinë

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. *Njoftimi për kontrate i datës* **19.04.2024**
2. *Dosja e tenderit e datës* **19.04.2024**

3. *Korrigjimi i Dosjes se tenderit*

4. *Sqarimi i Dosjes se tenderit*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të ulët

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia ne Trajtim/ jo-Diskriminimi

Neni 27 Dosja e tenderit

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te pa kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrim te dates 05.07.2024, "**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**" ne lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit – ritender** me nr te prokurimit: **214-24-3710-2-1-1** dhe nr. te brendshëm **214-24-14-211,** duke pasur parasysh se në këtë aktivitet të prokurimit jemi palë me interes juridik material konform nenit **4 paragrafi 1.26 i LPP-së**, pasi që në mënyrë të drejtëpërdrejtë e dëshmojmë se shkelja e Autoriteti Kontraktues na shkakton dëm neve si Operator Ekonomik dhe i shkakton dëm buxhetit të shtetit, prandaj jemi te pa kënaqur me Vendimin e AK-së, pasi që na ka eleminuar neve pa të drejtë, kurse ka rekomanduar për kontratë OE "LAGUNA" SH.P.K me çmim më të lartë, andaj ushtrojmë këtë:

ANKESË

Pretendimi nr.1

Po e elaborojmë në mënyrë kronologjike vërejtjet tona, sepse ne jemi eleminuar si të pa përgjegjshem nga AK në mënyrë të pa drejtë. Së pari po ju informojmë se AK na ka eleminuar me arsyetimin se GOE "Aroma Plus" SH.P.K dhe "Natural Store" SH.P.K është i pa përgjegjshem. Me date 18.06.2024 ka kërkuar me anë të letres standarde për sqarime te tenderit per ti sjellur mostrat dhe ka rezultuar se GOE i ka mostrat e shamponit të duarve janë ekologjike, ndërsa edhe të tjerat janë në rregull dhe na shpallë të pa përgjegjshëm. Si është e mundur qe ne si OE te jemi në rregull me dokumentacion duke i plotësuar të gjitha kërkesat e AK dhe duke ju përgjigjur letrave standarde ashtu siç i ka kërkuar AK dhe njëkohësisht të na shpallë të pa përgjegjshëm. Njëkohësisht me datë 24.06.2024, AK ka kërkuar sqarime në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta dhe AK ka marre përgjigje nga ne si GOE të cilën përgjigje AK e ka cilësuar si të pa justifikueshme shpjegimin sipas çmimit të ofertes mujore dhe na ka eleminuar si të pa përgjegjshëm. Ne si GOE "Aroma Plus" SH.P.K dhe Natural Store" SH.P.K,

pasi kemi pranuar **B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit,** ne në afat ligjor i kemi dorzuar mostrat e materialit te cilat jane kerkuar prane AK se bashku me faturat:

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE, "GJ.K.SKENDERBEU P.N." 42000 VUSHTRRI

Data: 18.06.2024

„Aroma Plus & Natural Store – Prishtinë

Nr. i prokurimit:	**214-24-3710-211**
Nr i brendshëm	**214 24 14 211**

Titulli:Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit- ritender

I/e nderuar(a) z.Mirvete Krasniqi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:
Për të realizur këtë kontratë duhet që artikujt me numër rendor : **3,6,9,12 dhe 13** të sillen fizikisht në zyren e prokurimit mostrat e tyre së bashku me fatura të furnizimeve dhe të dëshmohen që produktet janë ekologjike sipas deklaratave që keni dhënë.

3	Dezinfektues, detergjent për pastrimin e nyjave sanitare (Pllakave, guacave dhe lavamanëve). Domestos ose ekuivalent	copë	60

6	Detergjent i lëngshëm	litër	100
9	Detergjent të posaçme për xhama të dritareve	litër	30
12	Material për pastrimi i lavamanëve dhe rubineteve me mjete zbardhuese dhe lustrim	litër	20
13	Sapun për duar i lëngshëm	litër	360

Gjithashtu duhen të dëshmohen me fatuara të rregullta të furnizimeve edhe artikujt 1 dhe 2

1	Letër peshqiri për duar, tufë, standarde komercial 1/200 fletëza	copë	1500
2	Letër tualeti 2 ply 1/10	copë	500

Andaj, për te vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar tenderin tuaj lusim që përgjigjjet tuaja ti dërgoni përmes platformes eprokurimit.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen prej nesh brenda **| 2 |** **ditëve** nga data e kësaj kërkese.

Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,

Bekim Dakaj ,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

Ne i kemi dorezuar mostrat tek AK ashtu siç janë kërkuar, për pozicionin nr.3, 6, 9, 12 dhe 13 si dhe per artikujt 1 dhe 2 dhe ju kemi drejtuar me ane te kesaj shkrese. (shiko me poshtë)

SH.P.K

.AROMA PLUS
Kontakti: +383 (0) 45 655 558
Email: shpk.aroma@gmail.com
Adresa: Rr.Ndue Perlleshi, LL-A3 – Prishtinë Kosovë

Për: Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Nga: GOE ''Aroma Plus'' SH.P.K dhe Natural Store SH.P.K

Datë: 19.06.2024

I nderuar AK,

Dje me date 18.06.2024, pasdite kemi pranuar nje leter standarde per sqarimin e tenderit per proceduren e prokurimit ''Sherbimet e Mirembajtjes dhe Pastrimit'' Ritender me nr. te prokurimit 214-24-3710-211 dhe nr. te brendshem 2142414211 per artikujt me nr. rendor 3,6,9,12 dhe 13 si dhe per artikujt 1 dhe 2 .

Ne neser gjatë ditës do t'i sjellim faturat dhe artikujt (mostrat) ashtu siç i keni kërkuar.

Te gjithë këta artikuj qe do t'i sjellim neser, janë ekologjik dhe bio ashtu siç kemi deklaruar.

(këto janë koncentrate). Disa artikuj jane me litra disa artikuj janë copë, te gjithe artikujt qe i prezentojme 3,6,9,12 dhe 13 janë koncentrate.

Aroma Plus SH.P.K

Shoq. AROMA PLUS Prishtinë

pastaj me datë 24.06.2024 kemi pranuar **B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo normalisht te ulet,**

Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

jo-normalisht të ulët

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE, "GJ.K.SKENDERBEU P.N." 42000 VUSHTRRI

24.06.2024

„Aroma Plus & Natyral Store - Prishtinë

Nr. i Prokurimit:	**214-24-3710-2-1-1**
Nr i brendshëm	**214/24/14/211**

Titulli: Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit- ritender

I/e nderuar(a) Z. *Mirvete Krasniqi*

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim " LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.
Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim:

Pyetje 1:

1.Ju lutem na jepni sqarime lidhur me oferten mujore që keni ofertuar 14.853,00 euro duke i pasur parasyshtë gjitha këto shpenzime si ;
-27 puntorë me 380 euro rroga mujore = 10260 euro
- 1 mbikqyres me 430 euro rrogë moujore = 430 euro,
-Materialin për pastrim mujor gjithsejt 28 lloje të artikujve edhe atë i gjithë artikujt janë ekologjik na sqaroni si keni ardhur deri te ky qmim.

Informatat e kërkuara duhet te pranohen me shkrim në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues,**në sistemin e eprokurimit elektronik** brenda *2* **dite** nga data e kësaj kërkese.

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Ju falënderoj paraprakisht,

Ne si OE jemi pergjigjur si më poshtë:

SH.P.K

AROMA PLUS
Kontakti: +383 (0) 45 655 558
Email: shpk.aroma@gmail.com
Adresa: Rr.Ndue Perlleshi, LL-A3 – Prishtinë Kosovë

Per: Akademia e Kosoves per Siguri Publike
Nga: OE "Aroma Plus"
Datë: 25.06.2024

Dje, më datë 24.06.2024 kemi pranuar nje letër standarde e kërkeses për informata mbi tenderin e pastrimit me titull: **"Sherbimet e Mirembajtjes dhe Pastrimit – Ritender" me nr. te prokurimit 214-24-3710-2-1-1 dhe nr.te brenshem 214/24/14/211.** Ne do ju japim pergjigje rreth pyetjes tuaj lidhur me këtë procedurë të prokurimit. Ne kemi ofertuar me çmim 14,853.00€, duke i llogaritur pagat e punëtorëve të menaxherit dhe materialin.

Siç edhe ju e keni potencuar në letrën standarde se OE është i obliguar t'i punesoje 27 punëtore me page mujore 380.00€ bruto, me te gjitha tatimet në vlerë prej 10 260.00€ si dhe një menaxher me page bruto mujore 430.00€ me te gjitha tatimet. Totali i ketyre dy shumave është 10 690.00€ + TVSH-ja për këtë pozicion është 1924,2 që do të thotë është e barabartë 12 614.2€, ndërsa ju e keni potencuar edhe çështjen e materialit mujor ku gjithsej jane 28 lloje të artikujve , ku për këto pozicione kemi paraparë material në vlere rreth 2 200.00€, duke llogaritur nje fitim minimal. Qëndrojmë pranë mostrave te cilat i kemi prezantuar para juve si Autoritet Kontraktues ku të gjitha materialet janë ekologjike me prejardhje nga BE (koncentrate të cilat perzihen me ujë), do t'i sjellim sipas kërkesës suaj dhe mostrat të cilat i kemi sjellur. Sa i perket sasise se materialit, po ju informojme se kemi sasi të mjaftueshme në depo ku lirisht ju mund te formoni nje komision dhe mund të konstatoni ne vendin e ngjarjes rreth këtij materiali, sepse ne si kompani operojmë edhe me nje kompani tjeter "Aroma Plus" GMBH në Gelsenkirchen të Gjermanisë.

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Aroma Plus SH.P.K
AROMA PLUS
Prishtinë

SH.P.K
AROMA PLUS
Kontakti: +383 (0) 45 655 558
Email: shpk.aroma@gmail.com
Adresa: Rr.Ndue Perlleshi, LL-A3 – Prishtinë Kosovë

Per: Akademia e Kosoves per Siguri Publike, Zyra e Prokurimit
Nga: OE "Aroma Plus"
Datë: 25.06.2024

DEKLARATË

Ne si GOE "Aroma Plus" SH.P.K dhe "Natural Store" SH.P.K, deklarojme me përgjegjësi të plotë materiale dhe ligjore, se do të realizojmë me përpikmëri të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit me titull "Sherbimet e Mirembajtjes dhe Pastrimit – Ritender" me nr. te prokurimit 214-24-3710-2-1-1 dhe nr.te brenshem 214/24/14/211.

Aroma Plus SH.P.K.

Shoqëri me përgjegjësi të limituara AROMA PLUS Prishtinë

Pra, si është e mundur që AK të na shpallë si të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, kur ne ju kemi përgjigjur çdo kërkese të cilat na ka kërkuar AK, ku në letren standarde për tenderet e eleminuar e thekson edhe vet se mostrat e materialeve (shamponit per duar) kanë rezultuar se janë ekologjike, ndërsa edhe të tjerat janë në rregull. Ne jemi të diskrimunuar nga AK për arsyje se tenderi jonë ka qenë me çmim më të ulët në vlerë prej 356,472.00€ duke i plotësuar të gjitha kriteret e Dosjes se tenderit, ndersa është shpallur fitues OE"LAGUNA" SH.P.K me çmim më të lartë prej 540,000.00€ me një diferencë prej 183,528.00€, ku shihet qartë se këtu është dëmtuar rëndë buxheti i Republikës së Kosovës, gjithashtu neni 1, paragrafi 1 i LPP-së thotë: *1." Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të*

autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.'' Ndërsa OE tjerë që kanë qenë pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit janë eleminuar për shkak se disa OE nuk i kanë sjellur mostrat, ndërsa disa OE tjerë nuk e kanë sjellur shamponin për duar ekologjik ashtu siç janë kërkuar nga AK.

Po e elaborojmë arsyetimet e AK për ne dhe secilin Operator Ekonomik.

ARSYETIM

1.Aroma Plus Sh.p.k. & Natyral Store Sh.p.k. - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe ka rezultuar se O.E. i ka mostren e shamponit të duarve ekologjike ndërsa tjerat janë në rregull.
Njëkohësisht me datë **24.06.2024** i kemi kërkuar sqarim lidhur me qmimet jo normalisht të ulta dhe kemi marr përgjigjje nga O.E. e cila ka qenë e pa justifikuar shpjegimi sipas qmimit te ofertes mujore dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.Mobile Sanitary Services Shpk - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe O.E. nuk i ka sjellur fare mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së dhe as faturat.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.Krasniqi Sh.p.k. & Pro Tech Clean Sh.p.k. - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe O.E. nuk i ka sjellur fare mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së , si dhe te lista e mjeteve i mungon art. Nr. 16.Kofe për xhoker për pastrimin e dyshemesë 50 copë dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.**Guard De Capital & Rio Plus** - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe ka rezultuar se O.E. nuk i ka mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së dhe as faturat.
Njëkohësisht me datë **24.06.2024** i kemi kërkuar sqarim lidhur me qmimet jo normalisht të ulta dhe nuk kemi marr asnjë përgjigjje nga O.E. dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.
Rio Plus Sh.p.k. i mungon çertifikata e TVSH-së.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.Internacional Group Base & Skyfterat –Live – është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe O.E. nuk i ka sjellur fare mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së dhe as faturat.
Njëkohësisht me datë **24.06.2024** i kemi kërkuar sqarim lidhur me qmimet jo normalisht të ulta dhe nuk kemi marr asnjë përgjigjje nga O.E. dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.E-Commerc Kosova Shpk & Capital X Fet Shpk - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe ka rezultuar se O.E. nuk i ka mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së ,
Njëkohësisht me datë **24.06.2024** i kemi kërkuar sqarim lidhur me qmimet jo normalisht të ulta dhe kemi marr përgjigjje nga O.E. e cila ka qenë e pa justifikuar shpjegimi sipas qmimit te ofertes mujore dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.Extrem Clean Sh.p.k. - është i papërgjegjshëm pasi që i mungojnë kërkesat e D.T. si :
-Sigurimi i tenderit, lista e punëtorëve , lista e kontratave , deklaratat tatimore për vitet 2021,2022,2023, vendimin me shkrim për caktimin e menaxherit, listen e mjeteve të punes, deklaraten e produkteve ekologjike, deklaraten për specifikim teknik të nënshkruar dhe vulosur, deklaraten me shkrim për pagat e punëtorëve dhe menaxherit si dhe referencat.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.Erik Sh.p.k. - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe ka rezultuar se O.E. nuk i ka mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së ,
Lista e punëtorëve i mungon një puntorë pasi që puntori me emer Remzi Latifi nuk është pjese e punëtorëve që punon, por i njëjti ka dal kët vit në pension.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1. Efa Dienstleistung Gmbh dega Kosovë - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe ka rezultuar se O.E. nuk i ka mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së ,
Njëkohësisht me datë **24.06.2024** i kemi kërkuar sqarim lidhur me qmimet jo normalisht të ulta dhe kemi marr përgjigjje nga O.E. e cila ka qenë e pa justifikuar shpjegimi sipas qmimit te ofertes mujore dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

ARSYETIM

1.Shafberger Jr.Gmbh -Dega Kosovë - - është i papërgjegjshëm pasi që **18.06.2024** i kemi kërkuar leter standarde për sqarimin e tenderit për sjelljen e mostarave dhe ka rezultuar se O.E. nuk i ka mostrat e shamponave ekologjike sipas kërkeses së AK-së ,
Njëkohësisht me datë **24.06.2024** i kemi kërkuar sqarim lidhur me qmimet jo normalisht të ulta dhe kemi marr përgjigjje nga O.E. e cila ka qenë e pa justifikuar shpjegimi sipas qmimit te ofertes mujore dhe është eliminuar si i papërgjegjshëm.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Bekim Dakaj

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

Autoriteti Kontraktues në mënyre të kunderligjshme na ka eleminuar si të pa përgjegjshëm duke u thirrur në çmimet jo normalisht të uleta, në këtë rast AK ka shkelur nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik të Republikes se Kosovës, ku thotë se: *41.1 "Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës. 41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë."*

Mirëpo AK absolutisht nuk ka vepruar sipas nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik te Republikës së Kosovës, AK ka shkelur këtë nen dhe përgjigja e AK ndaj nesh ka qenë duke thënë: *"Kemi kërkuar sqarime në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta dhe kemi marrë përgjigje nga*

OE të pa justifikuar. Nuk e kuptojmë se çfarë ka dashur të thotë AK me fjalën të "pa justifikuar" dhe menjëherë të na shpallë të pa përgjegjshëm duke shkelur nenin 41 të Rregullores se LPP-së, ku ne si GOE përpos përgjigjes në letren standarde kemi dhënë edhe një deklaratë, ku kemi deklaruar se në përpikmëri do ti realizojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë 11 Operator Ekonomik, ku 9 prej Operatoreve Ekonomik kemi konkuruar me çmime të përafërta. Ndërsa, ka shpallur fitues OE me çmim shumë më të lartë.

Me datë 15.07.2024 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim per aktivitetin e prokurimit "**Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit – ritender** me nr. te prokurimit: **214-24-3710-2-1-1 dhe nr. te brendshem 214-24-14-211** te iniciuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike, pa asnje shpjegim detal ashtu siç e parasheh ligji , mirepo vetem me nje arsyetim te thjeshte duke thënë se: *"Pretendimet e OE se jane shkelur neni 1, 6, 41, 7, 27 nuk qendron per faktin se tek Aneksi i DT tek Specifikimet Teknike ka qene e specifikuar sakte se çka kërkohet nga OE "*.

Parashtrohet pyetja se tek ky vendim AK nuk e ka specifikuar se çka ka dashur të thotë me këtë fjali, për çka bëhet fjalë, ku ne te vetmit si OE i kemi dorezuar mostrat e materialeve ekologjike ashtu siç është kërkuar në DT, ku edhe vet AK ka konstatuar në letren standarde e sqarimit të tenderit se OE e ka mostren e shamponit te duarve ekologjike ndersa edhe te tjerat janë në rregull. Nuk e kuptojme se si eshte e mundur te na shpalle te papergjegjshem kur ne e kemi plotesuar kete kriter, ndersa OE tjere te cilet i ka eleminuar, asnje nga ata mostrat e shamponit dhe mostrat tjera nuk i kane sjellur ashtu siç eshte kerkuar ne DT, qe mostrat te jene ekologjike. Pasataj, ne kete arsyetim AK thote se me date *24.06.2024, i kemi kerkuar OE sqarime lidhur me cmimet jo normalisht te uleta dhe kemi marre pergjigje nga OE e cila ka qene e pajustifikuar shpjegimi sipas cmimit te ofertes mujore dhe shpenzimet e materialit higjenik ekologjik mujor dhe eshte eleminuar si i papergjegjshem.*

Pra, si eshte e mundur qe AK te mos japë kurfare sqarimesh, vetem te na eleminoje se pergjigja se ju si OE e keni dhene si te pa justifikueshme. Nuk qendron fakti se ne kemi dhene pergjigje te pa justifikueshme, sepse, ne menyre shume te qarte e kemi elaboruar ne kerkesen per rishqyrtim, mirepo AK as qe e ka lexuar kerkesen per rishqyrtim, sepse, ne qofte e kishte lexuar kete kerkese ateher AK eshte dashur te na jep shpjegime per secilin pretendim qe ne e kemi paraqitur ne kete kerkese per rishqyrtim. Pra, ne nuk do t'i perserisim edhe nje here nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik të Republikes se Kosovës i cili eshte shkelur nga ana e AK ,

sepse, per te konstatuar se Operatoret Ekonomik kane dhene oferte jo normalisht te ulet duhet te plotesohen disa kritere, shiqo me larte neni 41 te Rregullores se LPP-së.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe t'i respektojë ne përpikmëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me kete lloj te aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Grupi të Operatorëve Ekonomik : "Aroma Plus" SH.P.K. dhe "Natural Store" SH.P.K. në lidhje me aktivitetin e prokurimit:" **Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit - ritender** me nr. te prokurimit: **214-24-3710-2-1-1 dhe nr. te brendshem 214-24-14-211** te iniciuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

ANULOHET Vendimi i AK-së për proceduren e prokurimit lidhur me aktivitetin:" **Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit - ritender"** me nr. te prokurimit: **214-24-3710-2-1-1 dhe nr. te brendshem 214-24-14-211** te iniciuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*